



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja **b**, neni 40, shkronja **I** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2.5 dhe nenit 17 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, Udhëzimit administrativ nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor, nenit 15, paragrafi 15.1. shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2019, merr këtë

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN
"MATI 1" - VAZHDIMI I RRUGËS "B" (BAHRI FAZLIU) – PJESA JUGORE, 2019 - 2027**

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

MIRATOHET Vendimi i Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Matit 1" – vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu) – pjesa jugore, 2019 – 2027.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, si çështje e përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me miratimin e Planit rregullues të hollësishëm, nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale, dhe me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.



Neni 4

Kufiri i territorit

Territori i Planit rregullues të hollësishëm për zonën “Matit 1” – vazhdimi i rrugës “B” (Bahri Fazliu) – pjesa jugore, 2019 -2027, përfshin sipërfaqe prej S= 4.12 ha, ku parcelat kadastrale që shtrihen brenda kufirit të hapësirës që trajtohet janë:

ZK, Prishtinë: 2708-2, 2709-0, 2710-7, 2710-5, 2710-4, 2710-6, 2710-1, 2710-10, 2710-3, 2712-7, 2717-1, 2712-1, 2712-13, 2712-8, 2710-2, 2712-2, 2712-3, 2712-5, 2712-9, 2712-4, 2712-12, 2714-38, 2714-36, 2714-43, 2714-16, 2712-6, 2714-15, 2714-40, 2714-14, 2715-0, 2716-1, 2712-11, 2712-10, 2708-3.

ZK, Matigan: 1411-0, 905-1, 905-2, 899-0, 898-0, 900-0, 901-0, 902-0, 896-4, 879-0, 883-2, 880-2, 878-2, 896-1, 896-2, 2713-0.

Neni 5

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 të Ligjit nr. 04/L-174, përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve të veta njerëzore, ka emëruar ekipin profesional, i cili e ka hartuar Planin rregullues të hollësishëm.

Neni 6

Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë 8-vjeçare.

Neni 7

Gjuha zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 8

Programi

Pjesë e këtij vendimi është Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 3 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/01-239151/19, më 30.09.2019

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

